

 **RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS**  
**TELEVISIONI**  
NR 0576/10  
DATA: 17.03.2010  
PRISHTINË

**Radio Televizioni i Kosovës**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur  
Për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavazur.....	3
Bilanci i Gjendjes.....	5
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	6
Pasqyra e Krijdhës së Parasë.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet.....	8
Shënime të pasqyrave financiare.....	9-24

## **Raport i Auditorëve te pavarur**

**Bordit te Drejtoreve te Radio Televizionit te Kosovës**

Ne kemi audituar pasqyrat e bashkangjitura te "Radio Televizionit te Kosovës" (me tutje referohet si "RTK" apo "Kompania") te cilat përbehen nga Bilanci i Gjendjes me 31 Dhjetor 2009, Pasqyra e Operacioneve, Pasqyra e rrjedhës së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon në këtë datë, si dhe përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënimet tjera sqaruese të përfshira në faqet 5 deri në 24.

Pasqyrat Financiare të Kompanisë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2008 janë audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në të cilin raporti nuk janë të prezantuara Pasqyrat Financiare për të cilat jepet opinioni.

### ***Përgjegjësit e menaxhmentit për pasqyrat financiare***

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejt të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të mbrendshëm që është i rëndësishëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejt të këtyre pasqyrave financiare që janë të liruar nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjes dhe aplikimit të politikave të duhura kontabël; dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

### ***Përgjegjësia e Auditorit***

Përgjegjësi e jona është të shprehim një mendim në këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe planifikojmë dhe zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë pasqyrat financiare të liruar nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë performimin e procedurave që të arrijmë evidencë audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varën nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga gabimi apo mashtrimi.

Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e mbrendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejt të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnoj procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia audituese që kemi siguruar është e njafueshme dhe e duhur që të ofrojë bazë për mendimin tonë.

### **Mendimi**

Në mendimin tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2009, si dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### **Çështjet e theksuara**

Duke mos e kualifikuar mendim tone, ne tërheqim vëmendjes si më poshtë:

- i. Kompania ende nuk e ka të zgjidhur statusin e saj për sa i përket çështjes së TVSH-së, si pasojë e kësaj Kompania ka të njohur kërkesa nga TVSH-ja të prezantuara në shënimin 6 në vlerë prej 697 mijë euro.

### **Çështje tjera**

Si është shpjeguar në shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare, mbledhja e tarifës për hyrat e Kompanisë nga kuota e parapagimit prej 3.50 Euro është pezulluar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese të marrë me datë 16 Tetor, 2009. Operacionet e Kompanisë në të ardhmen do varen nga vendimi i Kuvendit të Kosovës për mënyrën e financimit të mëtejshëm të Kompanisë.


Audit & Conto  
11 Mars, 2009

NDERMARRJA SHËRBËVESE  
**AUDIT & CONTO**  
sh.p.k.  
PRISHTINË


**Bilanci i Gjendjes**

	Shënimi	Me 31 Dhjetor 2009 (ne 000 euro)	Me 31 Dhjetor 2008 (ne 000 euro)
<b>Pasuritë</b>			
<b>Pasuritë jo qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	2,770	2,616
Pasuritë e patrupëzuara-Serialet	5	1,871	1,377
		<b>4,641</b>	<b>3,993</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Stoqet e materialit shpenzues		262	224
Llogarite e arketueshme dhe te tjera	6	1,550	5,026
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	7	125	53
		<b>1,937</b>	<b>5,303</b>
<b>Totali i pasurive</b>		<b>6,578</b>	<b>9,296</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali Shuqëror	8	8,224	8,224
Deficitet e Akumuluar		(1,007)	(1,078)
Suficiti / (Deficiti) i vitit		(2,251)	71
<b>Totali i ekuitetit</b>		<b>4,966</b>	<b>7,217</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet jo qarkulluese</b>			
Detyrime afatgjata	9	266	119
		<b>266</b>	<b>119</b>
<b>Detyrimet qarkulluese</b>			
Llogarite e pagueshme dhe te tjera	10	1,267	1,857
Tatimet e pagueshme		79	103
		<b>1,346</b>	<b>1,960</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,612</b>	<b>2,079</b>
<b>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</b>		<b>6,578</b>	<b>9,296</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 15 Shkurt 2010 dhe nënshkruar nga:

  
Sytejzan Shijaqi

Drejtor i Përgjithshëm

  
Bajram Spahiu

Drejtor Financiar

## Pasqyra e Operacioneve

Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2009 (ne 000 euro)	2008 (ne 000 euro)
Te hyrat nga parapagimi (KEK-u)	7,080	8,652
Te hyrat nga reklama	11 2,541	1,493
Te hyrat tjera	12 164	244
<b>Gjithsejtë te hyra</b>	<b>9,785</b>	<b>10,389</b>
<b>(Shpenzimet) operative</b>		
Shpenzimet e pagave	13 (4,264)	(3,904)
Shpenzimet e zhvlerësimit	4 (1,410)	(1,480)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	14 (5,388)	(4,905)
Provizionet për borxhe të këqija	6 (1,826)	(36)
<b>Gjithsejtë shërbimet</b>	<b>(12,888)</b>	<b>(10,325)</b>
<b>Suficiti / (Deficiti) operativ</b>	<b>(3,103)</b>	<b>64</b>
Te hyra nga provizionimi i detyrimeve	10 852	7
<b>Suficiti / (Deficiti) i vitit</b>	<b>(2,251)</b>	<b>71</b>

## Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2009 (ne 000 euro)	2008 (ne 000 euro)
<b>Aktivitetet Operative</b>			
Suficiti / (Deficiti) i vitit		(2,251)	71
<i>Përshatur për:</i>			
Zhvlerësimin	4	1,410	1,480
Provizionet për borxhe të këqija	6	1,826	36
Te hyrat nga provizionimet e detyrimeve	10	(852)	(7)
Shlyerjet e kërkesave	6	(188)	(42)
<b><i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapital punues</i></b>		<b>(55)</b>	<b>1,538</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>			
Stoqet		(38)	6
Të arkëtueshmet e tjera tregtare	6	1,837	(620)
Detyrimet e tjera dhe tregtare	10	238	479
		<b>2,037</b>	<b>(136)</b>
<b>Aktivitetet Investuese</b>			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	5	(722)	(306)
Blerja e pasurive të patrupëzuara	5	(1,336)	(1,175)
		<b>(2,058)</b>	<b>(1,481)</b>
<b>Aktivitetet Financuese</b>			
Kredi afatgjatë	9	147	40
		<b>147</b>	<b>40</b>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalentët e parasë</b>			
		<b>72</b>	<b>(39)</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit</b>	<b>7</b>	<b>53</b>	<b>91</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>7</b>	<b>125</b>	<b>53</b>

Shënimet sqaruese prej faqe 9 deri ne 24 formojnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare. 7

## Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet

	Kapitali shoqëror (ne 000 euro)	Deficitet e mbajtura (ne 000 euro)	Total ekuiteti (ne 000 euro)
Me 1 Janar 2008	8,224	(1,078)	7,146
Suficiti i vitit	-	71	71
<b>Me 31 Dhjetor 2008</b>	<b>8,224</b>	<b>(1,007)</b>	<b>7,217</b>
Deficiti i vitit		(2,251)	(2,251)
<b>Me 31 Dhjetor 2009</b>	<b>8,224</b>	<b>(3,258)</b>	<b>4,966</b>



## 1. Informata te përgjithshme

Radio Televizioni i Kosovës është institucion publik me rendësi të posaçme kulturore dhe kombëtare, i cili ofron shërbim publik në fushën e veprimtarisë së radios dhe televizionit, e themeluar në përputhje me Rregulloren Nr. 2001/13 të UNMIK-ut, për themelimin e Radio Televizionit të Kosovës, e datës 15 Qershor 2001.

Themelues i RTK-ës si institucion publik është Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës mbron autonomi institucionale dhe pavarësinë editoriale si dhe të sigurojë financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-ës. Me qëllim të sigurimit të funksionit të plotë në nivel profesional të RTK-ës themeluesi po ashtu garanton sigurimin e objekteve të përshtatshme punuese.

Veprimtarinë e ka të përcaktuar me Ligjin për RTK-ën Nr.02/L-47 të datës 11.04.2006

Entiteti është me bazë në Prishtinë, Kosovë dhe siguron shërbimin e transmetimit në gjithë rajonin e Kosovës duke u udhëhequr nga parimet e një Transmetuesi Publik, në përputhje me Kapitullin II, Neni 4 ; Ligji për RTK-ën Nr.02/L-47 të datës 11.04.2006

Entiteti aktualisht vepron me një televizion dhe dy radio, të gjitha të vendosura në Prishtinë.

Në përputhje me Kapitulli III, Neni 19 Paragrafi 19.1; i Ligji për RTK-ën Nr.02/L-47 Kuvendi i Kosovës do të siguroj një kornizë financiare të përshtatshme të sigurte dhe transparente e cila garanton mjete të nevojshme RTK-ës për ta përmbushur misionin e saj. Prej momentit të hyrjes në fuqi të Ligjit për RTK-ën Nr.02/L-47 Kuvendi i Kosovës me Nenin 20.1 ka caktuar një kuotë fikse parapagimi prej 3.50€ në muaj për çdo subjekt fizik apo juridik. Subjekt konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë energjie elektrike apo një faturë tjetër publike. Kuota fikse prej 3.50€, e cila deri me tani është mbledhura nga Korporata Energjetike e Kosovës, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 16 Tetor 2009 është pezulluar mbledhja e kësaj kuote. Deri me tani nuk ka ndonjë vendim të Kuvendit të Kosovës për mënyrën e financimit të RTK-së.

Organi drejtues i RTK-ës do të jetë Bordi i RTK-ës i përberë prej 9 anëtarëve të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës. ( Kapitulli V Neni 23 paragrafi 23.1

Bordi i RTK-ës shqyrton dhe miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhimit dhe të personelit tjetër dhe siguron që burimet e RTK-ës nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare Kapitulli VI neni 26 paragrafi 7

Numri i punonjësve në entitet me 31 Dhjetor 2009 ishte 734; duke përfshi të punësuarit e rregullt 459 punëtorë, me kontrata të përkohshme/kontrate mbi vepër 78; dhe bashkëpunëtor profesional/bashkëpunim programor dhe kontraktarë tjerë 197 punëtorë.

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

### **2.2 Baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën Parimin e Kujdesit të Duhur. Entiteti ka të garantuar qëndrueshmërinë e saj financiare me ligjin për themelimin e saj edhe pse mbledhja e taksës prej 3.50 euro e cila përfaqëson të hyrën kryesore të Entitetit është pezulluar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 16 tetor 2009.

### **2.3 Standardet dhe Interpretimet që janë në lëshim dhe nuk janë adoptuar ende**

Me datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet dhe interpretimet vijuese kanë qenë në lëshim por nuk kanë qenë në fuqi:

SNRF 1 "Adoptimi për here të parë i SNRF-ve" në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Korrikut 2010.

Përmisimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Përmisimet në SNRF 5 "Asetet jo qarkullues të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Përmisimet në SNRF 8 "Segmentet Operuese", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe matja", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2013.

Përmisimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Përmisimet në SNK 7 "Pasqyra e mjedhës së Parase" në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Përmisimet në SNK 17 "Qiratë", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Përmisimet në SNK 24 "Shpalosja e transaksioneve me pale të ndërlidhura", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2011.

Përmisimet në SNK 39 "Instrumentet financiare: Prezantimi", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Shkurtit 2010.

Përmisimet në SNK 36 "Dëmtimi i Aseteve", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Përmisimet në SNK 39 "Instrumentet financiare: Njohja dhe matja", në fuqi për periudha që fillojnë me apo pas 1 Janarit 2010.

Kompania ka zgjedhur që të mos adoptoj këto standarde, korrigjime dhe interpretime para datës së hyrjes së tyre në fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve,

## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Korrigjimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit të tyre fillestar.

### 2.4 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euroja (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euroja ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

## 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

### 3.1 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.

Asetet dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diference ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit.

### 3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi. Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Kompaninë dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet ngarkohen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur. Zhvlerësimi në asetet llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën neto të aseteve për të shpërndarë koston e tyre në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon:

TV, Radio dhe pajisjet kompjuterike	5 vite
Mobilje dhe orëndi	5 vite
Mjete transportuese dhe inventar ekonomik	5 vite

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigjohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shumën e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

**3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)****3.3 Asetet e paprekshme**

Asetet e paprekshme përbëhen nga serialet dhe të drejtat televizive të blera. Këto fillimisht maten sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën e saldos së zbritur duke përdorur përqindjet në vijim:

	Transmetimi i I	Transmetimi i II	Transmetimi i III
Kosto e zhvillimit të serialit	50%	30%	10%

**3.4 Dëmtimi i aseteve jo-financiare**

Asetet që kanë kohë të pakufizuar të përdorimit nuk i nënshtrohen amortizimit dhe testohen në baza vjetore për dëmtim. Asetet të cilat i nënshtrohen amortizimit rishikohen për dëmtim kurdoherë kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera e bartur mund të mos jetë e rikuperueshme. Humbja nga dëmtimi njihet për shumën më të cilën vlera e bartur e asetit e tejkalon shumën e rikuperueshme të atij aseti. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës reale të asetit minus kostoja e shitjes dhe vlera në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, asetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rjedha të identifikueshme të veçanta të parave (njësi që gjenerojnë para). Asetet jo-financiare që kanë pësuar dëmtime rishikohen për rikthime të mundshme të dëmtimit në secilën datë raportuese.

**3.5 Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare që ndodhen në bilanc të gjendjes përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat e kontabilitetit mbi njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse të kontabilitetit që janë të përfshira në këtë shënim. Kompania i klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes së ndërlidhur kontraktuale. Interesat, fitimet dhe humbjet që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si asete ose detyrime raportohen si të hyra ose shpenzime, respektivisht. Instrumentet financiare thyhen kur Kompania ka një të drejtë të zbatuar me ligj për të bërë thyerjen dhe ka për qëllim që ta zgjidh ose në baza neto apo që të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

**3.6 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare njihen fillimisht sipas vlerës së tyre reale dhe më pas maten sipas shumës së rikuperueshme, minus provizionet për dëmtime. Një provizion për dëmtimet në llogaritë e arkëtueshme tregtare vendoset kur ekzistojnë dëshmi objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje që të mbledh të gjitha shumat që ia kanë horxh sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme. Vështirësitë e theksuara financiare të debitorit, mundësia që debitori do të hyjë në bankrotim apo riorganizim financiar, dhe mospagim apo gabimet në

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

pagesa (tejkalimet për më tepër se 30 ditë) konsiderohen si indikatorë që llogaritë e arkëtueshme tregtare janë dëmtuar.

Vlera e bartur e asçit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie të lejimit, dhe shumat e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Kur një llogari e arkëtueshme nuk mund të arkëtohet, ajo shlyhet përkundër një llogarie lejimi për llogaritë e arkëtueshme. Arkëlimet pasuese të shumave paraprakisht të shlyera kreditohen në pasqyrën e të ardhurave.

#### **3.7 Stoqet**

Materialet, pjesët rezervë dhe materiali shpenzues vlerësohen sipas parimit të çmimit më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara në sigurimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin dhe konditat ekzistuese. Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes.

#### **3.8 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në bankë. Për qëllime të rrjedhës së parasë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme paraqesin paratë e gatshme në dorë dhe depozitat e pakufizuara në banka me periudhë maturimi prej 3 muaj ose më pak.

#### **3.9 Huamarrjet**

Huamarrjet paraqesin kreditë që janë marr nga institucionet financiare dhe maten sipas vlerës së tyre reale në kohën e njohjes fillestare dhe pas njohjes fillestare sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

#### **3.10 Kostot e përfitimeve të pensionimit**

Kompania nuk bënë provizionin dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre të paguara pranë Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

#### **3.11 Tatimi**

Në përputhje me rregulloren e UNMIK-ut nr 2001/13 për Tatimin në Fitim në Kosovë e datës 20 Shkurt 2002, dhe rregulloren e UNMIK-ut nr 2004/51 e datës 04 Dhjetor 2004, Entiteti është i liruar nga tatimi në fitim, si institucion publik i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

#### 3.12 Njohja e të hyrave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e Entitetit kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë.

Të ardhurat njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike.

Të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me të njëjtin transaksion ose ngjarje tjetër njihen njëkohësisht; në harmoni me principin e përputhjes.

#### 3.13 Grantet qeveritare

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet e këtyre grantëve dhe që ato grante do të pranohen.

Grantet qeveritare kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

Grantet tjera qeveritare njihen si e hyrë gjatë periudhave të nevojshme për t'i barazuar ato me shpenzimet të cilat ato kanë për qëllim t'i kompensojnë, në mënyrë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet apo humbjet që tani kanë ndodhur apo që kanë për qëllim dhënie e përkrahjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa shpenzime që lidhen me të ardhmen njihen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

#### 3.14 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim të tanishëm si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën dhe është e besueshme që një rrjedhë e burimeve që paraqesin përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të paguar një detyrim, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në lidhje me shumën e obligimit. Provizionet rishikohen gjatë secilës datë të bilancit të gjendjes dhe korrigjohen me qëllim që të reflektojnë vlerësimin më të mirë aktual.

#### 3.15 Zotimet dhe kontingjentet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent shpallet në të gjitha rastet përveç rasteve kur mundësia e rrjedhës së burimeve që paraqesin përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpallet kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e një humbjeje kontingjente njihet si provizion nëse është e besueshme që ngjarjet në të ardhmen do të konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri më datën e bilancit të gjendjes dhe se mund të bëhen një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që pason.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

#### **3.16 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë**

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara në Shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të asetëve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshëm nga këto vlerësime.

#### **3.17 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim**

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një trezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të asetëve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

##### ***Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare:***

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave dhe shlyerjen e tyre. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

##### ***Vlerësimi i provizioneve për llogari të pagueshme:***

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për pagesën e llogarive të pagueshme. Duke u bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për llogaritë e pagueshme dhe bën shlyerjen e tyre. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

## 4. Prona, impiantet dhe pajimet

Kosto	Pajisjet për transmetim (ne 000 euro)	Automjetet (ne 000 euro)	Pajisje dhe kompjuter (ne 000 euro)	Pajisje tjera (ne 000 euro)	Investime ne vijimi (ne 000 euro)	Totali (ne 000 euro)
Me 01 Janar 2008	7,481	220	238	181		8,120
Blerjet gjatë viti	122	85	52	47	11	306
<b>Me 31 Dhjetor 2008</b>	<b>7,603</b>	<b>305</b>	<b>290</b>	<b>228</b>	<b>11</b>	<b>8,437</b>
<b>Zhvlerësimi i Akumuluar</b>						
Me 1 Janar 2008	(4,919)	(85)	(102)	(89)		(5,195)
Zhvlerësimi i viti	(533)	(42)	(32)	(19)		(626)
<b>Me 31 Dhjetor 2008</b>	<b>(5,452)</b>	<b>(127)</b>	<b>(134)</b>	<b>(108)</b>		<b>(5,821)</b>
<b>Vlera neto</b>						
Me 1 Janar 2008	2,562	135	136	92	0	2,925
Me 31 Dhjetor 2008	2,151	178	156	120	11	2,616
Blerjet gjate vitit-2009	84	232	145	8	253	722
Transferimet gjate vitit				264	(264)	0
Zhvlerësimi i viti	(442)	(39)	(42)	(45)		(568)
<b>Vlera neto</b>						
<b>Me 31 Dhjetor 2009</b>	<b>1,793</b>	<b>371</b>	<b>259</b>	<b>83</b>	<b>264</b>	<b>2,770</b>

Te përfshira ne pajisjet për transmetim dhe automjetet janë asçet ne vlera 1,175 mijë euro te cilat janë te lëna peng për kreditin e marre gjate vitit 2009.



## 5. Asetet e patrupëzuara /serialet

	Familja moderne	Kafeneja Jone	Oksigjeni	Frekuenca e quzës	Te tjera	Totali
	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)
Vlera neto me 1 Janar 2008	297	465		100	194	1,056
Blerjet gjate vitit 2008	236	520	348	32	39	1,175
Amortizimi gjate vitit 2008	(158)	(347)	(226)	(21)	(102)	(854)
<b>Vlera neto me 31 Dhjetor 2008</b>	<b>375</b>	<b>638</b>	<b>122</b>	<b>111</b>	<b>131</b>	<b>1,377</b>
Blerjet gjate vitit 2009	283	546	427	14	66	1,336
Amortizimi gjate vitit 2009	(190)	(365)	(278)	(9)		(842)
<b>Vlera neto me 31 Dhjetor 2009</b>	<b>468</b>	<b>819</b>	<b>271</b>	<b>116</b>	<b>197</b>	<b>1,871</b>

**6. Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera**

	Me 31 Dhjetor 2009	Me 31 Dhjetor 2008
	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)
<b><u>Llogarite e arkëtueshme tregtare</u></b>		
Llogarit e arkëtueshme KEK-u	2,224	4,179
Provizioni për borxhe te këqija Keku	(1,702)	
Kërkesat nga klientët-Marketing (me kompensim)	111	249
Kërkesat nga CMB	43	80
Kërkesat ndaj transmetuesve	40	80
Provizioni për borxhe te këqija dhe te dyshimta	(127)	(190)
	<b>589</b>	<b>4,398</b>
<b><u>Kërkesat tjera</u></b>		
Kërkesat ndaj Donatoreve	10	10
Kërkesat nga Shfrytëzuesit e objektit	136	111
Avancat e dhëna	98	92
Kërkesat për TVSH	697	406
Kërkesa tjera	20	9
	<b>961</b>	<b>628</b>
<b>Total llogarit e arkëtueshme dhe kërkesat tjera</b>	<b>1,550</b>	<b>5,026</b>

**Lëvizjet ne provizionin për borxhe te këqija**

	Me 31 Dhjetor 2009	Me 31 Dhjetor 2008
	(ne 000 euro)	(ne 000 euro)
Bilanci me 1 Janar	(190)	(196)
Te provizionuara gjate vitit	(1,826)	(36)
Shlyerjet gjate vitit	188	42
<b>Bilanci me 31 Dhjetor</b>	<b>(1,829)</b>	<b>(190)</b>

**7. Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

	Me 31 Dhjetor 2009 (ne 000 euro)	Me 31 Dhjetor 2008 (ne 000 euro)
Paraja ne banke	125	53
Paraja ne arke	-	-
	<b>125</b>	<b>53</b>

**8. Ekuiteti**

Kapitali Shoqëror i Entitetit në Bilancin e Gjendjes është i përbërë si më poshtë:

	(ne 000 euro)
Pajisje të dhuruara nga Qeveria Japoneze	7,848
Donacion nga EAR	10
Donacione tjera në Kesh	366
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>8,224</b>

Shuma prej 7,848 mije euro lidhet me donacionin e pajisjeve dhëne RTK-ës nga Qeveria Japoneze përmes UNMIK-ut gjatë vitit 2000, shuma totale përfshinë 6,891 mije euro të dhëna për pajisje të televizionit dhe 957 mije euro për pajisje të radios. Kosto e pajisjeve është regjistruar direkt si Kapital Shoqëror që kur është dhuruar për qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të RTK-ës.

Shuma prej 10 mije euro lidhet me donacionin e dhëne nga Agjensioni Evropian për Rindërtim gjatë vitit 2002 për pajisje të televizionit.

**9. Detyrimet afatgjata**

	Me 31 Dhjetor 2009 (ne 000 euro)	Me 31 Dhjetor 2008 (ne 000 euro)
Kredia ne ProCredit Bank	59	119
Kredia ne ProCredit Bank	207	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>266</b>	<b>119</b>

Gjate vitit 2009 Kompania ka nënshkruar një kontratë për kredinë me ProCredit Bank për financimin e blerjes së veturave në vlerë 215 mije euro. Marrëveshja për kredinë është nënshkruar me 23 Shtator 2009. Kredia bart një normë fikse të interesit prej 11.90 %. Afati i kthimit të kredisë është 5 vite.

**10. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera**

	Me 31 Dhjetor 2009 (ne 000 euro)	Me 31 Dhjetor 2008 (ne 000 euro)
<b><u>Llogaritë e pagueshme tregtare</u></b>		
Furnitorët vendore	1,714	1,699
Furnitorët e huaj	331	148
Provizionimi i llogarive të pagueshme	(850)	(1)
	<b>1,195</b>	<b>1,846</b>
<b><u>Detyrimet tjera</u></b>		
Obligimet ndaj sigurimeve shëndetësore	21	
Obligimet për paga për punëtorë	15	10
Obligime tjera	36	1
	<b>72</b>	<b>11</b>
<b>Total llogaritë të pagueshme dhe detyrime tjera</b>	<b>1,267</b>	<b>1,857</b>

**11. Te hyrat nga reklama**

	Te hyrat nga reklamata (ne 000 euro)	Te hyrat nga vendosja e produkteve (ne 000 euro)	Gjithsejtë të hyrat -2009 (ne 000 euro)
Te hyrat nga reklama -shitjet me para	651	86	737
Te hyrat nga reklama-shitjet me kompensim	1,382	422	1,804
	<b>2,033</b>	<b>508</b>	<b>2,541</b>

**11/a Shpenzimet për te hyrat nga Reklama – te cilat i paguhen CMB-is**

Me kontratën Nr.2541/08 e datës 30.12.2008 RTK-ja i jep te drejtën ekskluzive kompanisë CMB që në emër dhe për llogari të RTK-ës të realizoj të hyra nga shitja e hapësirës reklamuese për vitin 2009 dhe 2010. Kjo kontratë është vazhdimësi e kontratës së datës 22.12.2007

Me kontratën Nr.2541/08 Neni 5 është paraparë që për hapësirën reklamuese të realizuar për RTK-ën, RTK-ja të paguaj CMB-is provizionin sipas kësaj përqindje:

- Deri 1,300,000.00€ 10%
- Prej 1,300,000.00 deri 1,500,000.00€ 15%
- Mbi 1,500,000.00€ 20%

**Raporti i Provizionit i përllogaritur për CMB-isë për vitin 2009**

	Realizimet	Përqindja për CMB	Provizioni për CMB
	1,300,000.00	10%	130,000.00
	200,000.00	15%	30,000.00
	1,040,444.67	20%	208,088.93
<b>Totali</b>	<b>2,540,444.67</b>		<b>368,088.93</b>
		TVSH	58,894,23
<b>Totali për pagesë</b>			<b>426,983.16</b>

## Te hyrat nga reklama për shitjet ne para te gatshme (te klasifikuara sipas klientëve) janë si vijon:

Klienti	Sekonda te shpezuar (sasi)	Çmimi mesatar/sek. (euro)	Total te hyrat nga sekondat (ne 000 euro)	Te hyrat nga vendosja e produkteve (ne 000 euro)	Gjithsejtë te hyrat (ne 000 euro)
Partite politike	100 355	4.24	426		426
Ipko	5 962	4.13	25	11	36
KFK-u	6 547	1.74	11		11
Kolexhet Shkalllore	1 824	2.22	4		4
Shrypi Ditor	3 443	1.80	6		6
MTI	287	5.00	2		2
ProCredit Bank				11	11
MUPT	930	5.00	5		5
OSCE	1 890	4.96	9		9
AKP	21 559	2.20	47		47
PTK	3 992	11.37	45		45
Raiffaisen Bank	28 232	2.02	57		57
Kujtesa				37	37
Loto-Xhirim				22	22
Te tjera	7 792	1.70	13	5	18
	<b>182 613</b>	<b>3.57</b>	<b>651</b>	<b>86</b>	<b>737</b>

## Te hyrat nga reklama për shitjet me kompensim (te klasifikuara sipas klientëve) janë si vijon:

Klienti	Sekonda te shpenzuar (sasi)	Çmimi (euro) mesatar/sek.	Total te hyrat nga sekondat (ne 000 euro)	Te hyrat nga vendosja e prod. (ne 000 euro)	Gjithsejtë te hyrat (ne 000 euro)
Jeta ne Kosove	29 763	4.08	121	24	145
Emisioni Oxygen	13 145	4.50	59	44	103
Emisioni pa rotulla	33 571	3.45	116		116
Emisioni Mifloneri	22 628	12.92	292	68	360
Telekuizi				41	41
Daxa Elektronik	451	4.00	2		2
Kolegji Viktory	1 008	6.00	6		6
Te tjera	65 661	3.14	201	136	337
	<b>166 227</b>	<b>5.00</b>	<b>797</b>	<b>312</b>	<b>1,109</b>

**Te hyrat nga teleshoppingu (kompensim), klientet me qarkullim të madh (ku sipas shumores fitojn zbritje të medha); reklama për institucione me rendësi të veçant dhe reklama gratis**

Klienti	Sekonda të shpenzuar (sasi)	Gjithsejtë të hyrat (në 000 euro)
Teleshopping	859 476	171
CMB	233 515	412
Stypi ditor	55 650	111
Reklamat e emeluar për institucione me karakter publik	83 421	
	<b>1 232 062</b>	<b>694</b>



**12. Te hyrat tjera**

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2009 (ne 000 euro)	2008 (ne 000 euro)
Te hyrat nga urimet	7	9
Te hyrat nga vendosja e antenës	25	18
Te hyrat nga transmetimet	20	82
Te hyrat nga parkingu	14	7
Te hyrat nga qiraja	47	78
Te hyra tjera	51	28
Te hyrat tjera-Financimi nga subjekte qeveritare		22
	<b>164</b>	<b>244</b>

**13. Shpenzimet e personelit**

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2009 (ne 000 euro)	2008 (ne 000 euro)
Pagat e punëtorëve të rregullt	3,076	2,778
Paga me kontrata njëvjeçare	483	578
Pagat e kontraktuarra- Menaxhmenti	102	99
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor- Punëdhënësi	31	
Kontributet pensionale	251	237
Shtesat- Kontrata Kolektive	321	212
	<b>4,264</b>	<b>3,904</b>

**14. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative**

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2009 (ne 000 euro)	2008 (ne 000 euro)
Shpenzimet e furnizimit të materialit	47	29
Shpenzimet e energjisë elektrike	78	63
Shpenzimet për ujë dhe mbeturina	36	29
Mëditjet e Bordit	51	36
Reforma, arsimimi dhe trajnimi	13	141
Shpenzime për përkthime dhe sinkronizim	35	46
Shërbimet kontraktuese- Korrespondentët	266	382
Big Bandi i RTK-së	77	76
Shpenzimet për telefon	108	119
Shpenzimet për internet dhe Web faqe	26	34
Shpenzimet tjera për udhëtim zyrtar	20	66
Shpenzimet e mëditjeve	97	65
Shpenzimet e udhëimit- Biletat	33	40
Shpenzimet për karburante	81	124
Mirëmbajtja e automjeteve	45	38
Mirëmbajtja e pajisjeve	58	49
Shpenzime për tarifen 3,5€ KEK	425	519
Shpenzime për reklama SMB	368	159
Provizioni bankar	9	15
Shërbimet mjekësore	9	11
Talimi në pronë	17	25
Shpenzimet operacionale të Bordit	12	10
Shpenzimet për licenc- KPM	31	
Mikpritja për mysafirë	25	25
Kontrata me EBU dhe Fidar	123	125
Shpenzimet tjera- KTTN-ja	40	40
Shpenzimet tjera- Sateliti	182	187
Shpenzime të ndryshme	48	40
5% nga parapagimi për zyrën e kryeministrit	329	399
Shpenzimet për shpalljet	109	90
Shpenzimet për programe	1,854	1,049
Shpenzimet për drejtat e sportit	483	746
Shpenzimet për skenografi	28	23
Parapagimi për Kosova Live	14	7
Programi i vitit të ri	95	98
Produksionet e pavarura (20%)	116	
	<b>5,388</b>	<b>4,905</b>

## 15. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### **Rreziku kreditor**

Kompania i nënshtrohet rrezikut kreditor nëpërmjet aktiviteteve të saja të shitjes. Në këtë respekt, rreziku kreditor për Kompaninë buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të mos paguajnë obligimet e tyre sipas kontratës. Shuma e ekspozimit kreditor me këtë rast përfaqësohet nga shumat e bartura të llogarive të arkëtueshme në datën e bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e aseteve financiare të regjistruara në pasqyrat financiare, që është shuma neto nga dëmtimet, paraqet ekspozimin maksimal të Kompanisë ndaj rrezikut kreditor.

### **Rreziku i tregut**

Kompania nuk është futur në ndonjë transaksion të "mbrojtur/hedging" për të mbuluar ekspozimin e saj ndaj lëvizjes së çmimeve që rrjedhin nga operacionet e saj.

### **Rreziku nga norma e interesit**

Rreziku nga norma e interesit përbëhet nga rreziku që vlera e pasqyrave financiare do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe nga rreziku i ndryshimit ndërmjet maturimit të aseteve që janë me interes dhe maturimit të detyrimeve që janë me interes dhe janë marr për të financuar ato asete. Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit në një instrument financiar është fikse tregon se deri në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut nga norma e interesit.

Menaxhmenti beson se Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në pasqyrat e saj financiare përveç për huamarrjet, të cilat bartin normë fikse të interesit.

### **Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit reflekton paaftësinë e Kompanisë për të siguruar fonde për të përmbushur angazhimet e saj. Menaxhmenti monitoron drejtpërdrejtë likuiditetin e Kompanisë dhe pozitën e saj të rrjedhës së parasë. Kjo përfshin mirëmbajtjen e indikatorëve të likuiditetit të bilancit të gjendjes, koncentrimin e debitorëve dhe kreditorëve si në terma të miksit të përgjithshëm të financimit si dhe shmangien nga mbështetja e tepërt në konsumatorë të mëdhenj individual.

### **Rreziku nga kursi valutor i këmbimit**

Rreziku nga kursi i këmbimit shfaqet kryesisht kur ekzistojnë llogari të arkëtueshme ose të pagueshme për shkak të transaksioneve me ndërmarrje të huaja. Megjithatë, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj ndonjë rreziku domethënës nga kursi i këmbimit për shkak se shumica e transaksioneve kryhen në Euro.

### **Vlera reale e instrumenteve financiare**

Vlera reale është shuma për të cilën një aset mund të këmbëhet apo një detyrim mund të shlyhet, ndërmjet palëve me vullnet dhe të mirinformuara në një transaksion duar lirë. Menaxhmenti beson që vlera e bartur e të gjitha aseteve financiare dhe detyrimeve e reflektuar në pasqyrat financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale.

## 16. NGJARJET PASUESE

Pas fundit të vitit, Kuvendi i Kosovës ka vendosur që të subvencionoj operacionet e Entitetit për 6 muajt e parë të vitit 2010 deri sa të merret vendim për mënyrën e mbledhjes së taksës së RTK-së. Vendimi Nr.03-V-237 i datës 28 Janar 2010